




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA / AGENCY FOR GENDER EQUALITY

BULETINI INFORMATIV **#2015**



Prishtinë, 2015



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/ AGENCY OF GENDER EQUALITY

BULETINI INFORMATIV 2015

Përmbajtja

- **Iniciativat e Agjencisë për Barazi Gjinore**

Punëtorja me temë “Indeksit Gjinor si mekanizëm për përfshirjen e perspektives gjinore në politikat publike”	5
Promovohet Ligji i ri për Barazi Gjinore.....	6
Hulumtimi “ Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale dhe në partitë politike në Kosovë”	7
Publikimi i Raportit të parë Monitorues për Progresin e Implementimit të Planit të Veprimit për Zbatim të Rezolutës 1325 “Gratë, Paqja dhe Siguria”	8

- **Aktivitetet Avokuese**

Tryeza e diskutimit “Shënimi i 8 Marsit Ditës Ndërkombëtare të Gruas: Fillon procesi i hartimit të Udhëzimit Administrativ për Regjistrimin e Pronës në emrin e të dy Bashkëshortëve	9
Aktivitete e realizuara gjatë fushatë së 25 Nëntorit, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas -16 Ditët e Aktivizmit.....	10
Përkrahja e Organizatave Joqeveritare që promovojnë Barazinë Gjinore.....	11

- **Bashkëpunimet me Institucionet relevante**

Nënshkruhet marrëveshje për mbështetje pesë vjeçare në mes ABGJ-së dhe SIDA-s Suedeze	13
Ka filluar procesi i hartimit të Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit (2016-2020)	14
Publikimi i manualit “ Integrimi Gjinor në Planifikimin Hapësinor – Një qasje hap pas hapi për Komnat”	14
Prezantimi i Ligjit për Barazi Gjinore në Komuna	15
Punëtorja për të drejtën pronësore të grave	15
Fillon Ri-hartimi i kurrikulës për Barazi Gjinore	15

- **Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna**

- **Statistikat e të punësuarve në shërbimin civil të Kosovës**



▪ Foto e nga punëtorja e Indeksit Gjinor

Punëtorja dy ditore me temë “Indeksit Gjinor si mekanizëm për përfshirjen e perspektives gjinore në politika publike”

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Institutin Evropian për Barazi Gjinore në Vilnius të Lituanisë, të përkrahur nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë, kanë mbajtur punëtori dy ditore me 04 dhe 05 Qershor 2015, me temë “Indeksi Gjinor si mekanizëm për përfshirjen e perspektivës gjinore në politika publike”.

Kjo punëtori kishte si qëllim të analizojë të dhënat ekzistuese të mbledhura nga institucionet e Kosovës dhe të japë rekomandime konkrete për përgatitjen e një Raporti për Indeksin e Barazisë Gjinore në Kosovë, i cili do të hartohet në bazë të një metodologjie të unifikuar dhe do të ofronte rezultatet të bazuara në indikatorë të qëndrueshëm e të standardizuar.

Ekspertet nga Institutit Evropian për Barazi Gjinore prezantuan para të pranishmeve Indeksin e barazisë gjinore në BE, teknikat dhe instrumentet që do të përdoren për hartimin e indeksit edhe për vendin tonë.

Indeksi Gjinor përbëhet nga gjashtë fusha kryesore: Puna, paraja, pushtetit, njohuria, shëndeti, koha dhe dy fusha satelitore pabarazitë dhe dhuna. Pra raporti tregon boshllëqet ose pabarazitë në mes të femrave dhe meshkujve, arritja midis dy gjinive, si një tregues i caktuar gjinor, në mënyrë që të shmangen situatat ku mangësitë gjinore janë të ulëta, për të dy gjinitë gratë dhe burrat.

Raporti mbi Indeksin e barazisë gjinore do të ndihmonte Qeverinë e Republikës së Kosovës, Agjencinë për Barazi Gjinore dhe Agjencinë e Statistikave të Kosovës që të monitoronte politikën e ndërmarra deri më tani, si dhe të ndërmerre veprime adekuate në drejtim të zbatimit politikave publike të bazuara në nevoja dhe të përcjella me instrumente financiare. Indeksi gjinor do të avanconte të kuptuarit e barazisë gjinore si domen i interesit cili afekton të gjitha kategoritë, moshat, grupet e ndryshme të interesit që synojnë demokracinë, mirëqenien dhe ofrimin e mundësive të barabarta. Kjo praktikë do të ofroj një qasje të re në tejkalimin e vështirësive dhe matjes së efikasitetit me veprime të orientuara drejt barazisë gjinore.

Ndryshe, Institutit Evropian për Barazi Gjinore -Lituanian, është institucioni me i lartë në nivel Evropian i cili mbledh dhe analizon të dhëna të ndara në baza gjinore, dhe si rezultat ata kanë hartuar Indeksin Gjinor të BE i cili është instrument i vlerësimit të situatës mbi çështjet gjinore . Ky instrument bazohet në statistika dhe metodologji të unifikuar të analizës në nivel Evropian.

Përfaqësuesit nga Institutit Evropian për Barazi Gjinore ishin: Therese Murphy- Shefe e operacioneve ne IEBGJ, Kristaps Petermanis - Zyrtar i lartë nga IEBGJ dhe Karolina Vrethem- Zyrtare e politikave për barazi gjinore në Komisionin Evropian, si dhe ligjërueset e punëtorisë Anna Rita Manca, Zyrtare e Statistikës, IEBGJ dhe Irene Riobóo Lestón, Profesoreshë e Statistikave të Aplikueshme, Universiteti Rey Juan Carlos, Spanjë.

Punëtorja është përkrahur nga TAIEX (Instrumenti Ndihmës Teknik për Shkëmbimin e Informatave).

Promovohet Ligji i ri për Barazi Gjinore



▪ Foto nga promovimi i Ligjit për Barazi Gjinore

Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në bashkëpunim me Komisionin për Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në Kuvendin e Kosovës, kanë organizuar tryezë diskutimi, për promovimin e Ligjit të ri për Barazi Gjinore.

Kjo tryezë u organizua me qëllim të njoftimit të opinionit me ndryshimet e bëra në Ligjin për Barazi Gjinore, dhe u prezantuan obligimet dhe risitë që sjell ky ligj.

Në hapje të tryezës Kryeshefja Ekzekutive në Agjencinë për Barazi Gjinore, Edona Hajrullahu, tha se Kosova ka miratuar ligjin e parë për Barazi Gjinore që në vitin 2004, gjithsesi nevoja për të përmirësuar dhe avancuar gjendjen faktike të Barazisë Gjinore, si dhe për të përfshirë dhe sanksionuar me ligj edhe norma dhe rregulla të reja, është konsideruar si e arsyeshme të hartohet një ligj i ri, i cili do i adresonte më mirë boshllëqet e ligjit të kaluar. Sipas saj, procesi i hartimit të këtij ligji ka qenë mjaft i gjatë, por me një bashkëpunim të mirëfilltë të të gjithë akterëve, si dhe pas diskutimeve të shumta, më në fund është arritur të kemi një ligj bashkëkohor dhe që garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, siguron mundësi dhe trajtim të barabartë të grave dhe burrave, në sferën publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë jetën politike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet shoqërore, sportin, kulturën dhe sferat tjera.

Ndërsa, Kryetarja e Komisionit për të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione të Kuvendit të Kosovës Lirije Kajtazi ka thënë se qëllimi primari zbatimit të mbikëqyrjes mbetet vlerësimi i nivelit të zbatueshmërisë dhe sa kanë dal reale ligjet dhe politikat e miratuara. Natyrisht këto politika dhe ligje gjithherë duhet përcjellë dhe me zhvillimet socio politike në vend dhe më gjerë.

Avokati i Popullit Hilmi Jashari, gjatë tryezës foli për pakon e Ligjeve për të drejtat e njeriut në barazinë ligjore, për përparësitë që sjellin këto tri ligje. Ai tha se është e rëndësishme që të kërkohet raportim nga institucionet përgjegjëse në Kuvendin e Kosovës dhe se është mundësi e mirë që nga vërejtjen që mund të jepen në Kuvend të merren hapa konkret që do të mund të ndihmonin zbatimin e ligjit në praktikë.

ABGJ ka organizuar fushatë promovuese e cila konsiston në : publikimin e LBGJ, i cili është shpërndarë gjatë tryezës, publikimin e një fletushke me sqarime për nenet e caktuara të LBGJ sanksionet - gjobat, buxhetimi gjinor, teknikat e aplikimit si dhe të gjitha ato risi që janë në fuqi me Ligjin e ri, si dhe botimin e Billbordave i cili promovon : Kuotën e garantuar në fuqi –tani 50%, dhe është vendosur në disa pjesë të Kryeqytetit.

Billbordi dhe fletushka e realizuar për promovimin e Ligjit të ri për Barazi Gjinor.



Hulumtimi “ Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale dhe në partitë politike në Kosovë”



▪ Foto nga prezantimi i hulumtimit “Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale dhe në partitë politike në Kosovë”

Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar hulumtimin “*Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale dhe në partitë politike në Kosovë*”. Hulumtimi është realizuar përmes intervistimit të grave dhe vajzave në shërbimin civil dhe në parti politike. Ky hulumtim ka analizuar dhe identifikuar :

- pozitën e grave në institucionet qendrore, lokale dhe në partitë politike;
- sfidat dhe mundësitë me të cilat janë duke u ballafaquar gratë dhe vajzat në institucionet qendrore, lokale dhe partitë politike;
- Analizën e kornizës legislative, dhe politikave publike lidhur me pjesëmarrjen në vendimmarrje në institucione, në politike;
- Identifikimi i nevojave për ngritje të kapaciteteve institucionale në lidhje me promovimin dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje dhe politikë.

Rekomandimet për rritjen e përfaqësimit të grave në pozita vendimmarrëse në institucione publike qendrore dhe lokale:

- Promovimi i grave të suksesshme në pozita vendimmarrëse (56% e të anketuarave); të organizohen trajnime për gratë në fushën e menaxhmentit dhe leadershipit (55% e të anketuarave); dhe të ofrohen trajnime në motivimin e grave për të synuar pozita vendimmarrëse (47%);
- Përkrahje politike si dhe trajtimi i barabartë për gratë, në caktimin e grave në pozita vendimmarrëse dhe promovimin e tyre
- Ndryshimin e mentalitetit për rolin e gruas duke luftuar stereotipet në arsim, media dhe kulturë, dhe mbështetje për shkollimin e grave ndërmarrja e masave afirmative, ofrimi i bursave studimore për gratë janë mbështetur si masa nga afër një e treta e të anketuarave. Si dhe hapjen e më shumë çerdheve publike, por edhe brenda institucioneve, për përkujdesjen e fëmijëve, në mënyrë që të behet harmonizim i jetës profesionale me atë personale.

Rekomandimet për rritjen e përfaqësimit të grave në pozita vendimmarrëse në parti politike

- Forumet e grave duhet të bëhen funksionale dhe forcohen në mënyrë që të luajnë rol aktiv në rritjen e pjesëmarrjes së grave në parti politike, rritjen e përfaqësimit të grave në pozita vendimmarrëse dhe aktivizimin e grave në politikë
- Duhet promovuar demokratizimin brenda partive politike. Kjo do mund të realizohej përmes përfshirjes së kuotave në statutet e partive politike për përfaqësimin e grave në pozita vendimmarrëse si dhe obligimit që nëse kryetari i partisë është burrë atëherë një grua të jetë nënkryetare e partisë dhe anasjelltas; dhe, përmes aplikimit të sistemit të vet-nominimit për struktura vendimmarrëse në kuadër të partive politike
- Të konsiderohen programe afirmative për të përfshirë gratë në menaxhimin e zgjedhjeve qendrore dhe lokale,
- KQZ të raportoj për votat e fituara të secilës parti sipas gjinisë. Kjo do të informonte partitë politike për fuqinë e votueseve gra
- Organizimi i trajnimeve për të nxitur partitë politike për të aplikuar buxhetim gjinor, etj

Hulumtimi i publikuar dhe prezantuar ne tre gjuhë: <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ%20Pjesmarrja%20roli%20dhe%20pozitat%20e%20grave%20ne%20institucione%20qendrore%20lokale%20dhe%20parti%20politike.pdf>

Prezantohet Raporti i parë Monitorues për Progresin e Implementimit të Planit të Veprimit për Zbatim të Rezolutës 1325 “Gratë, Paqja dhe Siguria”

Agjencia për Barazi Gjinore ka publikuar, raportin e parë Monitorues për Progresin e Implementimit të Planit të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 “Gratë, Paqja dhe Siguria”.

Raporti i parë monitorues është përpiluar nga Grupi Teknik nën koordinimin e Divizionit për Raportim dhe Monitorim në Agjencinë për Barazi Gjinore dhe me përkrahje financiare dhe teknike nga Un Women. Prezantimi i raportit është bërë me qëllimin të informimit lidhur me progresin e arritur në periudhën nga janari i vitit 2013 deri në nëntor 2014 në implementimin e PV për 1325.

Më poshtë po paraqesim një pasqyrë të shkurtë të statusit të përgjithshëm të implementimit të 33 aktiviteteve të PV.

Objektivi I “Pjesëmarrje e rritur e grave në vendim-marrje dhe në proceset e ndërtimit dhe ruajtjes së paqes”. Nga 9 aktivitete që kanë kontribuar në pjesëmarrjen e rritur të grave në vendim-marrje dhe në proceset e ndërtimit dhe ruajtjes së paqes, caqet e përcaktuara për periudhën e raportimit janë arritur në 33% të aktiviteteve. Edhe 33% e aktiviteteve tjera ishin në zhvillim e sipër, ndërsa 2 (22%) aktivitete nuk kishin filluar ende. Për një aktivitet nuk ka qenë e mundur të vlerësohet statusin e implementimit pasi që nuk ka pasur të dhëna në dispozicion.

Objektivi II “Perspektiva gjinore e integruar dhe pjesëmarrja e rritur e grave në strukturat e sigurisë”. Lidhur me integrimin e perspektivës gjinore dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në strukturat Kosovare të sigurisë, 63,6% të aktiviteteve nga gjithsej 11 sosh për të cilat janë arritur caqet e caktuara apo ishin në zhvillim e sipër për t’u arritur. Ndërsa 36,3% e aktiviteteve nuk ishin filluar ende.

Objektivi III “Viktimat e dhunës seksuale, torturës dhe formave të tjera të dhunës së lidhur me konflikt/luftë kanë qasje në drejtësi” Caqet ishin arritur në 38,4% të aktiviteteve të implementuara nga gjithsej 13 aktivitete që kanë kontribuar për një qasje më të mirë në drejtësi, rehabilitim dhe riintegrim të mbijetuarve të dhunës seksuale, torturës dhe formave tjera të dhunës të lidhura me luftën. Gjashtë-6- (46,2%) aktivitete ishin në zhvillim e sipër duke u implementuar, dhe një aktivitet nuk kishte filluar ende. Në fund, nuk ka qenë e mundur të vlerësohet statusi i implementimit të një aktiviteti (7,7%) nga aktivitetet nën objektivin 3.

Objektivi III “Viktimat e dhunës seksuale, torturës dhe formave të tjera të dhunës së lidhur me konflikt/luftë kanë qasje në drejtësi” Caqet ishin arritur në 38,4% të aktiviteteve të implementuara nga gjithsej 13 aktivitete që kanë kontribuar për një qasje më të mirë në drejtësi, rehabilitim dhe riintegrim të mbijetuarve të dhunës seksuale, torturës dhe formave tjera të dhunës të lidhura me luftën. Gjashtë-6- (46,2%) aktivitete ishin në zhvillim e sipër duke u implementuar, dhe një aktivitet nuk kishte filluar ende. Në fund, nuk ka qenë e mundur të vlerësohet statusi i implementimit të një aktiviteti (7,7%) nga aktivitetet nën objektivin 3.



▪ Foto nga shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Gruas- 8Marsit

Shënohet 8 Marsi

Dita Ndërkombëtare e Gruas: Fillon procesi i hartimit të Udhëzimit

Administrativ për Regjistrimin e Pronës në emrin e të dy Bashkëshortëve

Me rastin e 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Agjencia për Barazi Gjinore organizoi tryezë diskutimi, për ta shënuar këtë ditë, si dhe për të iniciuar procesin e hartimit të Udhëzimit Administrativ për Regjistrimin e Pronës në emrin e të dy Bashkëshortëve.

E drejta në pronë, është një e drejtë themelore që garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik i vendit, si dhe nëpërmjet ligjeve në fuqi si :Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Familjen, Ligji i Trashëgimisë, Ligji mbi Pronën dhe Ligji kundër Diskriminimit.

Prandaj, duke u bazuar në Ligji për Barazi Gjinore, ABGJ ka ndërmarrë hartimin e masave të veçanta (udhëzim administrativ) si masë afirmative të përkohshme, me qëllim që ky udhëzim administrative të përcaktoj mënyrën dhe mundësit stimuluese për regjistrimin e pronës edhe në emrin e gruas si bashkëpronare, për te siguruar pjesëmarrjen e barabartë të saj me burrat në të drejtën e pronës se paluajtshme.

Me këtë rast Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, Edona Hajrullahu, gjatë takimit foli mbi rëndësinë e Ditës Ndërkombëtare të Gruas si një festë e cila sjell të kaluarën në të tashmen, duke na kujtuar kështu luftën e grave për liri , dinjtet, drejtësi dhe barazi, si dhe duke na kujtuar rëndësinë dhe rolin e grave jo vetëm për familjen, por edhe për vendin gjithashtu.

Ndërkaq, Kryetarja e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione Lirije Kajtazi, ka thënë se shqetësimet e grave në përgjithësi edhe në rajon janë të njëjta me ato të vendit tonë. Sipas saj, ky takim do të ndikon në zbutjen e problemeve të cilat përfshijnë edhe familjen kosovare përgjegjësish, po në veçanti edhe gruan e cila është e atakuar mjaftë me problemet e shumta të cilat i ka shteti i jonë.

Murat Meha, Kryeshef Ekzekutiv në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka thënë se Ligjet janë ato të cilat e përcaktojnë mënyrën e shfrytëzimit dhe mënyrën e paraqitjes së pronësisë me të gjitha të drejtat që i takojnë pronarit. Ligjet dhe udhëzimet administrative që deri më tani kanë qenë dhe janë në fuqi, i përmbushin të gjitha kriteret për realizimin e këtyre të drejtave në mënyrë të barabartë për dy gjinitë.

Ndryshe, Hartimi i Udhëzimit Administrativ ”Regjistrimi i pronës në emrin e dy bashkëshortëve” do të fokusohet në: Lirim nga taksa fillestare e regjistrimit, reduktim i taksës në pronë /tatimi për vitin e parë, në rast se prona është e re dhe nuk ka tatim të akumuluar, si dhe reduktim i taksës së akumuluar të tatimit në pronë.

Agjencia për Barazi Gjinore ka nxjerr vendimin me të cilin ka themeluar Grupin Punues për Hartimin e Projekt Udhëzimit Administrativ për masat e veçanta për Regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve.

Grupi punues u përbë nga : Agjencia për Barazi Gjinore, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Zyra Ligjore e ZKM-së, Ministria e Financave, Ministria e Administrimit dhe Pushtet Lokal, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria për Kadastër e Prishtinës, mbështetur nga përfaqësues të USAID-it, dhe GIZ.

Po ashtu, janë mbajtur debate publike në pesë regjione: Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, ku kanë marrë pjesë nënkryetar të komunave, përfaqësues të asamblesë komunale, këshilltar komunal, drejtor, zyrtar kadastral, shoqëri civile, noter dhe media.

ABGJ në bashkëpunim me grupin punues ka përgatitur draftin final dhe është dërguar për miratim në mbledhje të Qeverisë së Republikës së Kosovës.



▪ Bilbordat e realizuar për fushatën e 16 Ditëve të Aktivizmit

25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas -16 Ditët e Aktivizmit

Me rastin e hapjes së Fushatës së 16 Ditëve të Aktivizimit, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministri ka organizuar tryezë diskutimi. Kjo ngjarje u shënuar në bashkëpunim me Koordinatorin Nacional kundër dhunës në familje, zv Ministrin e Drejtësisë Lirak Çelaj.

Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore Edona Hajrullahu, theksoi se në mbarë botën organizohen fushata sensibilizuese për eliminimin e dhunës ndaj grave edhe në sot jemi mbledhur për të shënuar se bashku fillimin e kësaj fushate, fushatë kjo e cila fillon me 25 Nëntor dhe përfundon me 10 Dhjetor.

Sipas saj, sapo të përmendim termin siguri na vjen natyrshëm të mendojmë në sigurinë territoriale, nacionale që janë çështje madhore, mirëpo takimi jonë i sotëm dhe simbolika e 16 ditëve të aktivizmit nënkupton një siguri të fokusuar në grupet më të ndjeshme të shoqërisë sonë ato të grave dhe vajzave, fëmijëve dhe të moshuarve. Prandaj, fenomeni i dhunës ndaj gruas, është fatkeqësisht një problem global, këtë e flasin si raportet ndërkombëtare ashtu dhe ato vendore, mirëpo ne si një demokraci e re duhet të jemi vigjilent dhe të përkushtuar në ofrimin e kushteve dinjitoze jetësore, që fillon me ndjenjën e të qenit i sigurt në shtëpi, shkolla, institucione, e me gjerë.

Kryetarja e Grupit Grupit të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës Blerta Deliu- Kodra gjatë takimit ka shprehur shqetësim lidhur me përmasat që po merr dhuna gjinore në vend. Veçanërisht kur rastet përfundojnë tragjikisht, duke përmendur rastin e Dijana Kastratit, tash të fundit Zejnepe Bytyqit Berish e shumë të tjera. Raste si këto janë alarm për

ne, që sundimin e ligjit duhet ta shtrijmë në të gjitha nivelet dhe ta kthejmë vëmendjen tek viktimat e dhunës në familje. Raste si këto pasqyrojnë mos efikasitetin e institucioneve të drejtësisë në parandalimin, zbulimin e deri në dënim të krimit, si dhe dekurajojnë viktimat e dhunës në familje që të raportojnë dhunën, ka thënë Deliu.

Sipas, Lirak Çelaj, Koordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje, përkrahja e fushatës e cila po organizohet është shumë me rëndësi ngase kjo ndikon në vetëdijesimin lidhur me dhunën në familje dhe në parandalimin e dhunës në familje. Zëvendësministri Çelaj theksoi se është e rëndësishme të shënohet kjo ditë dhe “16 Ditët e Aktivizmit” për sensibilizimin e opinionit publik që dhuna është fenomen jo civilizues, vetëdijesimi i gjeneratave të reja për rëndësinë e kultivimit të një familje pa dhunë dhe promovimin e vlerave të paqes dhe harmonisë familjare mund të reflektojnë në mbarë shoqërinë. Ai njoftoi të pranishmit me punën që është duke e bërë grupi punues i përbërë nga akterë institucionalë dhe të shoqërisë civile, të cilët kanë kontribuar me përvojat e tyre në hartimin e Programit të Kosovës kundër dhunës në familje dhe Planit të Veprimit. Njëherit përmendi edhe se kjo punëtorë është zhvilluar në tri shtylla: parandalimin, mbrojtjen-trajtimin dhe reintegrimin.

Gjatë tryezës u prezantuan te gjeturat e hulumtimit mbi dhunën në familje, të cilat i prezantoi Drejtoresha Ekzekutive e Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës Igballe Rogova. Ky hulumtim është vazhdim i hulumtimit me titull “Siguria fillon në Shtëpi” të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) 2008, i cili shqyrtoi kornizën ligjore, nivelin e vetëdijesimit në lidhje me dhunën në familje, format e dhunës në familje, si dhe institucionet që ofrojnë ndihmë.



- Sekuenca nga Video-spoti i realizuar për fushatën e 16 Ditëve të Aktivizmit

Në kuadër të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar edhe një serë aktivitetesh tjera, përveç tryezës. Janë përgatitur 8 Billborda me moton “Sa vlen jeta e Gruas, Nënës, Motrës, Vajzës tuaj si dhe ka përgatitur material promovues në kuadër të kësaj fushate.

Është realizuar edhe një video- spot televiziv me qëllim të njoftimit të qytetarëve për mekanizmat institucional të cilët ofrojnë ndihmë, në rastin kur një grua përjeton dhunë në familje. Ky video-spot është transmetuar në RTK gjatë fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit.

Po ashtu, gjatë fushatës së 16 ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës në Baza Gjinore, ABGJ në bashkëpunim me UN Women ndriçuan ndërtesën e Qeverisë së Kosovës me ngjyrë portokalli. Këtë vit ky organizim ka qenë iniciativë mbarë botërore, që simbolizon angazhimin e burrave dhe djemve për ta luftuar fenomenin e dhunës ndaj grave. Me këtë iniciativë Kosova iu bashkëngjiti shumë vendeve të botës që ndërmoren një iniciativë të tillë.



Përkrahja e Organizatave Joqeveritare që promovojnë Barazinë Gjinore

Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, dhe dokumenteve tjera me rëndësi të cilat promovojnë mundësitë e barabarta, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/02/2012 për Subvencionimin e Projekteve nga Fusha e Barazisë Gjinore, si dhe mandatit të saj, ABGJ ka përzgjedhur projektet të cilat promovojnë barazinë gjinore, pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, dhe fuqizimin ekonomike të tyre.

Të drejtë përfitimi për mbështetje financiare të projekteve kanë pasur personat fizik të cilët kryejnë aktivitete për zbatimin e normave të përgjithshëm të barazisë gjinore, dhe personat juridik të cilët janë aktiv në fushën e barazisë gjinore

Gjithsej janë përzgjedhur tetë projekte që i kanë plotësuar kushtet dhe specifikat e parapara sipas Udhëzimit Administrativ 01/2012.

Agjencia për Barazi Gjinore ka subvencionuar projektin “Përpunimi dhe konservimi i frutave dhe zhvillimi i turizmit rural në Komunën e Deçanit” të OJQ-së JETA. Përmes këtij projekti u është mundësuar femrave trajnimi disa ditorë në përgatitjen, përpunimin dhe konservimin e frutave, për zhvillimin e turizmit rural, produkte artizanale dhe në pavarësimin ekonomik të tyre. ABGJ ka përkrahur projektin në blerjen e materialeve për punimet artizanale, blerja e materialit për qepjen e veshjeve kombëtare, si dhe shpenzime për ushqime tradicionale. Në fund të projektit është hap edhe panairi ku janë promovuar ushqime tradicionale dhe veshje me motive kombëtare.

Aktivitetet Avokuese



▪ Foto nga projekti “Përpunimi dhe konservimi i frutave dhe zhvillimi i turizmit rural në Komunën e Deçanit”



▪ Foto nga projekti “Dizajni në Rrobaqepësi dhe Përkrahja e Grave dhe Vajzave për Punësim në Viset Rurale”

Ngritja e mirëqenies familjare duke u bazuar në punën vetanake dhe nevojat familjare për punësim dhe nevojat bazike ushqimore dhe krijimin e mundësive për ofrimin e një vendi të punës për vetveten dhe familjen si dhe shfrytëzimin e të mirave natyrore në vendin tonë, ka qenë synimi kryesor i “Projektit Intevsiv- Bletari”. Agjencia për Barazi Gjinore ka subvencionuar këtë projekt duke e ndihmuar në rritjen e numrit të bletëve me qëllim të prodhimit të mjaltit cilësor dhe shërues. Me rritjen e numrit të bletarisë dhe prodhimin e mjaltit iu është mundësuar zgjerimi i të ardhurave financiare për familje dhe punësimi i disa grave të fshatit.

Agjencia për Barazi Gjinore ka subvencionuar projektin “Rritja e kapaciteteve dhe shtimi i numrit të vendeve të punës “të OJQ-së - Fabrika për paketim dhe konservim Rizona. Qëllimi kryesor i projektit ka qenë modernizimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve përpunuese të perimeve, përmes investimeve në zgjerimin e objektit për përpunim/konservim dhe ruajtjen e prodhimeve parafabrikimit, pajisjeve, makinave për ngarkim-shkarkim të prodhimeve, transport të produkteve të gratshme, në arritjen e standardeve të cilësisë si dhe në marketingun e produkteve.

Agjencia për Barazi Gjinore ka përkrahur projektin “Dizajni në Rrobaqepësi dhe Përkrahja e Grave dhe Vajzave për Punësim në Viset Rurale” në komunën e Lipjanit, ku përmes këtij projekti femrave ju është mundësuar ndjekja e kursit të rrobaqepësisë. Gjate kësaj kohe gratë dhe vajzat kanë vijuar trajnimet e prerjes dhe qepjes. Gjithashtu ABGJ ka mundësuar blerjen e dy makinave qepëse, ku ato kanë mësuar qepjen e rrobave dhe qëndisjen e mbulesave të ndryshme.

Në fund të projektit, njëzet pjesëmarrëse janë pajisur me çertifikata të cilat do t’ju mundësojnë grave dhe vajzave të gjejnë punë në sallone të ndryshme të rrobaqepësisë.

Agjencia për Barazi Gjinore ka subvencionuar pjesërisht projektin “Përmirësimi i pozitës së Gruas në vendimmarrje fuqizimi ekonomik dhe plotësimi i kushteve përmes përkrahjes ekonomike të kopshtit -Mësonjëtorja Qiriazi”. Projekti kishte si qëllim vazhdimin e punës së kopshtit M.Qiriazi, për plotësimin e disa nevojave të domosdoshme për këtë institucion, për të pas si rrjedhojë ekzistencën e mëtutjeshme të këtij kopshti, përkrahjen e femrës në vazhdimin e këtij biznesi, rritjen e numrit të fëmijëve përmes përmirësimit të kushteve. Gjithashtu qëllimi tjetër me rëndësi është edhe punësimi i tri grave edukatore- mirëmbajtëse brenda kohës së implementimit të projektit. Pra, ABGJ ka përkrahur projektin në përmirësimin e kushteve në kopsht me elemente dhe pajisje të domosdoshme si shtretër, tavolina për ngrënie, tepihë, si dhe pajisje tjera të cilat përmirësojnë kushtet e punës së këtyre grave edukatore.

Pra, parimi kryesor i projekti ka qenë punësimi i vajzave dhe grave kryefamiljare në fabrikën për paketim dhe konservim Rizona, pasi që edhe projekti ka pas prioritet punësimin e grave dhe vajzave nga viset rurale.

Agjencia për Barazi Gjinore ka përkrahur projektin “Panaire i produkteve artizanale e ushqimore tradicionale të OJQ-së Bleri”. Përmes këtij projekti janë promovuar aktivitete nga trashëgimia kulturore me theks të veçantë në ushqimet tradicionale e produkte artizanale nga kjo shoqatë dhe shoqatat e tjera të grave nga komunat tjera. Realizimi i këtij projekti ka mundësuar promovimin e vlerave tradicionale dhe ka ndikuar në ngritjen e vetëdijes për rritjen e kujdesit për zhvillimin dhe ruajtjen e ushqimeve tradicionale dhe produkteve artizanale për brezat e ardhshëm. ABGJ ka ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve për tenda dhe në botimin e fletëpalosjeve dhe posterëve.



▪ Foto nga projekti: “Panairi i produkteve artizanale e ushqimore tradicionale të OJQ-së Bliri”

Agjencia për Barazi Gjinore ka financuar pjesërisht projektin “Aktivitet psiko-sociale, edukativo shëndetësore dhe furnizim me inventar” të organizatës Autizmi Fletë. Projekti kishte synim tu mundësoj fëmijëve me autizëm aktivitete brenda qendrës, shëtitje në natyrë, kalërim në natyrë, shëtitje në parkun e Gërmisë si dhe furnizim me inventar. Pra, për ata fëmijë të krijohen kushte për një jetë të pavarur që të jenë pjesë aktive dhe e dobishme e shoqërisë.

Agjencia për Barazi Gjinore ka përkrahur projektin “Zyre për Kontabilitet dhe Auditim”, me këtë rast ABGJ ka mundësuar blerjen e pajisjeve kompjuterike si: softuer, pjesë harduerike, inventar, ku përfshihen tavolina për punë, karrige dhe pajisje të nevojshme për internet dhe material punues, ku do tu mundësohet femrave të kenë njohuri në këto lëmi, që të përgatiten për tregun e punës.

Nënshkruhet marrëveshje për mbështetje pesë vjeçare në mes ABGJ-së dhe SIDA-s Suedeze



▪ Foto e realizuar nga nënshkrimi marrëveshjes me SIDA-n

Agjencia për Barazi Gjinore ka financuar pjesërisht projektin “Aktivitet psiko-sociale, edukativo shëndetësore dhe furnizim me inventar” të organizatës Autizmi Fletë. Projekti kishte synim tu mundësoj fëmijëve me autizëm aktivitete brenda qendrës, shëtitje në natyrë, kalërim në natyrë, shëtitje në parkun e Gërmisë si dhe furnizim me inventar. Pra, për ata fëmijë të krijohen kushte për një jetë të pavarur që të jenë pjesë aktive dhe e dobishme e shoqërisë.

Agjencia për Barazi Gjinore ka përkrahur projektin “Zyre për Kontabilitet dhe Auditim”, me këtë rast ABGJ ka mundësuar blerjen e pajisjeve kompjuterike si: softuer, pjesë harduerike, inventar, ku përfshihen tavolina për punë, karrige dhe pajisje të nevojshme për internet dhe material punues, ku do tu mundësohet femrave të kenë njohuri në këto lëmi, që të përgatiten për tregun e punës.

Ka filluar procesi i hartimit të Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit (2016-2020)

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Koordinatorin Nacional kundër dhunës në familje zv. Ministrin e Drejtësisë Lirak Çelaj, kanë organizuar tryezë diskutimi, ku janë njoftuar të pranishmit me iniciimin e procesit të hartimit të Programit të ri të Qeverisë kundër dhunës në familje dhe planit të veprimit 2016-2020.

Ky program do të jetë një dokument strategjik- platformë pune për të gjithë akterët të cilët ofrojnë shërbime dhe përkujdesje për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë zingjirin e institucioneve dhe organizatave jo qeveritare që trajtojnë këtë dukuri negative me pasoja të mëdha për shoqërinë.

Me vendim të Ministrisë së Drejtësisë është formuar ekipi përgjegjës për hartimin e Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit (2016-2020).

Punëtorja e parë konsultative është mbajtur në muajin nëntor, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të institucioneve kryesore përgjegjëse për të zbatuar veprime kundër dhunës në familje në Kosovë, si edhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe të organizatave kryesore ndërkombëtare të përfshira aktivisht dhe të specializuara për trajtimin e fenomenit të dhunës në familje në Kosovë.

Publikohet manuali i Integritit Gjinor në Planifikim Hapësinor Një qasje hap pas hapi për Komunitat

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Asociacionin e Komunave të Kosovës, dhe në mbështetje të UN- Habitat-it, kanë publikuar manualin e Integritit Gjinor në Planifikim Hapësinor – Një qasje hap pas hapi për Komunitat.

Ky udhëzues nxjerr në pah praktikatat më të mira të procesit të planifikimit hapësinor me përfshirjen e perspektivës gjinore, dokument ky i cili do të ndihmojë nivelin qendror dhe lokalë, si dhe shoqërinë civile, për integrimin e aspektit gjinor në procesin e planifikimit hapësinor.

Planifikim hapësinor me perspektivë gjinore, nënkupton standarde që iu garantojnë grave dhe vajzave siguri personale, qasje të duhura në hapësirat publike, lëvizshmëri, strehim si dhe shërbime të ndryshme publike. Me fjalë të tjera, pushteti lokal gjatë konceptimit të hapësirave publike, si p.sh; ndërtimi kopshteve, ndriçimi i rrugicave apo edhe ofrimi i një shërbimi më të saktë të trafikut urban, duhet të lehtësojë rutinat e përditshme të vajzave dhe grave.

Hartimi i manuali të Integritit Gjinor në Planifikim Hapësinor është i nevojshëm për arritjen e mundësisë së barabartë, për gratë dhe burrat në mjedisin ku ata jetojnë dhe të përmirësohet pjesëmarrja e barabartë e burrave dhe grave, në përcaktimin e nevojave të qytetarëve, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës së tyre.

Punëtorja për të drejtën pronësore të grave

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Programin për të drejta të Pronës (PRP)USAID, organizuan punëtorin për Zyrtarë për Barazi Gjinore në Komuna, për të diskutuar çështjet që lidhen me qasjen e grave, për të ushtruar të drejtën pronësore në Kosovë.

Zyrtarët/et për Barazi Gjinore ndanë përvojat e tyre dhe diskutuan sfidat dhe mundësit për të arritur të gratë, sidomos atyre që jetojnë në zonat rurale. Aktivitetet potenciale si dhe mundësitë e bashkëpunimit janë propozuar në mënyrë që të koordinojmë përpjekjet në avokim dhe ngritjen e vetëdijes për të drejtat pronësore të grave.



Promovohet Ligji i ri për Barazi Gjinore në pesë regjione të Kosovës

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me OSBE kanë mbajtur punëtori lidhur me Promovimin e Ligjit për Barazi Gjinore, në pesë regjione të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Gjilan, dhe Pejë.

Në këto punëtori kanë marrë pjesë gjithsejtë 186 pjesëmarrës nga këto fusha; Nënkretarë të komunave, Drejtorë të drejtorive komunale, Këshilltarë të kuvendeve komunale, Shoqëria civile, media lokale etj.

Punëtoritë janë përcjellë me debate tejet konstruktive, ngase të pranishmit shfaqen interesim rreth ndryshimeve të bëra në Ligj, sfidave dhe mangësive.

Po ashtu Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe organizatën Helvetas Swiss Intercooperation projektin DEMOS, organizuan takimin e përbashkët në Prishtinë me Kryetarët e grupeve jo-formale të grave në Kuvendet e Komunave dhe Zyrtarët për Barazi Gjinore në nivelin komunal me qëllim të Prezantimit të Ligjit të ri për Barazi Gjinore, ndryshimeve dhe neneve të reja.

Fillon Ri-hartimi i kurrikulës për Barazi Gjinore

Agjencia për Barazi Gjinore, Instituti i Kosovës për Administratë Publike, Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit (GIZ) dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) kanë filluar bashkëpunimin për planin trajnues/modulin e ri të IKAP lidhur me barazinë gjinore për shërbyes civil.

Tabela 1. Pjesëmarrësit në diskutime	
Komuna	Pjesëmarrësit
Prishtinë (ZBGJ nga e tërë Kosova)	28
Gjakovë	10
Drenas	11
Skenderaj	5
Pejë	4
Deçan	25
Junik	1
Rahovec	21
Mamusha	5
Totali	110

Deri më tani, ABGJ, IKAP, GIZ dhe RRG-GK-ës, kanë bashkëpunuar në organizimin e një diskutimi me Zyrtarët për Barazisë Gjinore (ZBGJ) nga komuna dhe ministri në Prishtinë, po ashtu dhe diskutimin me shërbyesit civil dhe drejtorët e drejtorive komunale, përfshirë këtu edhe ZBGJ, Tabela 1 ilustron numëron e pjesëmarrësve nga secila komunë, pa përfshirë organizatorët.

Këto diskutime kanë pasur dy qëllime kryesore: 1) që shkurtimisht të prezantojnë ndryshimet e fundit në ligje të ndërlidhura me barazinë gjinore në Kosovë dhe në këtë mënyrë të arrijnë të rrisin vetëdijesimin në lidhje me ligjet dhe mekanizmat e reja ligjore; dhe 2) që t'i qasemi nevojave të të mësuarit dhe prioriteteve që kanë shërbyesit civil në mënyrë që t'i informojmë për përgatitjen e kurrikulës së re mbi barazinë gjinore.

Përveç kësaj, është krijuar një pyetësor, i cili është shpërndarë në fillim të secilit diskutim, në mënyrë që të lehtësoj vlerësimin e njohurive momentale të shërbyesve civil dhe zyrtarëve mbi kornizën ligjore, drejt identifikimit të nevojave të të mësuarit në të ardhmen. Të gjitha të dhënat nga pyetësorët janë futur në një data bazë në Excel për analizim të mëtejshëm.

Aktivitetet e realizuara nga Zyrtaret për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka organizuar aktivitet të shumta përgjatë vitit, duke filluar me shënimin e Ditës së Vajzave, tema e kësaj dite për çdo vit caktohet nga OKB dhe këtë vit tema e caktuar është: Fuqia e vajzës (vajzave) adoleshente – Vizioni për vitin 2030. Kjo ditë ndërkombëtare promovon trajtimin e barabartë, dhe mundësitë për vajzat në mbarë botën në fusha të tilla, si ligji, kujdesi shëndetësor, arsimimi dhe lirinë nga dhuna dhe abuzimi.

Gjatë këtij viti ZBGJ ka promovuar në të gjitha komunat e Kosovës Planin e Veprimit në Zbatim të Rezolutës 1325 “Gratë, Paqja dhe Siguria”, ku u mbajtën tryeza të rrumbullakëta, debate dhe aktivitete tjera. Prezantimi u bë në 31 komuna dhe në 74 shkolla të këtyre komunave (1,2, deri 6 shkolla për komunë). Qëllimi i mbajtjes së aktiviteteve, ligjëratave, debateve

ishite: Integrimi gjinor në fushën e arsimit në shkolla, përkrahja dhe përzgjedhja e femrës në vendimmarrje, grupe punuese, staf profesional, aktivitete të lira, në komisione të ndryshme, si në panele intervistuese, borde, shpallje të konkurseve, ndarje të shpërblimeve, bursa avancime, në komisione të ndryshme, në hartim të dokumenteve ligjore.

Me një angazhim të madh ZBGJ dhe përkrahje nga ministri dhe sekretarit të përgjithshëm është arritur që të mbahet punësoria një ditore me temë “Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor” ku kanë qenë pjesëmarrës të gjithë drejtorët dhe udhëheqësit e departamenteve. MASHT-i është Ministria e parë që ka përgatitur një dokument të tillë për të shërbyer si shembull për të tjerët. Ky aktivitet është realizuar në mbështetje të RrGGK.



▪ Aktivitet i realizuar nga ZBGJ në MASHT

Koordinatorja për të Drejta të Njeriut në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës si çdo vite edhe kësaj radhe vazhdon t'i kushtoj rëndësi të veçantë respektimit dhe avancimit të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore. Në kuadër të kompetencave të veta Njësisë për të Drejtat e Njeriut në kuadër të MFSK-së në vazhdimësi është angazhuar dhe angazhohet në mbrojtjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut si dhe në ngritjen e përfaqësimit të duhur të komuniteteve dhe femrave duke e zbatuar Kushtetutën e Vendit, Ligjet në Fuqi, Rezolutën 1325 të KS të OKB si dhe Politikat afirmative të MFSK-së.

Përqindja e femrave në MFSK është 32% ndërsa, përqindja e femrave të uniformuara në MFSK/FSK është 8.52%, përkatësisht 203 femra në uniformë në gradën e oficerit, nënoficerit dhe ushtarit. Si e arritur tjetër e rëndësishme është evidencuar përfshirja e barazisë gjinore në kurikulat e trajnimit bazik, po ashtu edhe shtimi i numrit të orëve të ligjëratave për të drejtat e njeriut dhe barazisë gjinore për trajnimin bazik në KDS.

Është realizuar hulumtimi, aktivitet që buron nga Plani i Veprimit në zbatim të Rezolutës 1325 “Gratë, Paqja dhe Siguria” të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Në këtë hulumtim janë analizuar statistikat dhe pjesëmarrja e rritur e femrave në strukturat e FSK-së, pozita e femrave pjesëtare e FSK si dhe vështirësitë që hasin femrat pjesëtare të FSK-së në kryerjen e detyrave të tyre.

Ky hulumtim u realizua në një periudhë kohore prej një muaji dhe në përputhje me afatin kohor të paraparë në Planin e Veprimit për vitin 2015. Në këtë hulumtim kemi aplikuar metodologjinë më efikase për mbledhjen e të dhënave për hulumtim.

Janë realizuar 151 anketa me femra të uniformuara në pozita të ndryshme në FSK, prej tyre edhe pjesëtare të komuniteteve të ndryshme, disa prej të cilave kanë plotësuar pyetësorin në gjuhën e tyre.

Target grupe të hulumtimit ishin femrat të cilat shërbejnë në Forcën e Sigurisë së Kosovës në të gjitha strukturat. Analiza e hulumtimit ka një rëndësi të veçantë sepse përmban të dhëna reale, të besueshme, e që do të thotë se rezultatet nuk mbështeten në konstatime por në të dhëna burimore dhe objektive. Në fund të analizës së hulumtimit janë listuar konkluzionet dhe rekomandimet që ju kemi prezantuar vendimmarrësve në MFSK dhe FSK.

Për nder të Ditës Ndërkombëtare të Gruas 8 Marsit, është mbajtur një debat lidhur me perspektivën gjinore në MFSK dhe FSK duke i promovuar vlerat e gruas gjatë gjithë etapave të zhvillimit.

Në kuadër të bashkëpunimit me Komisionin për Punë të Brendshme Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, kemi zhvilluar takim me anëtarin e Komisionit Ganimete Musliu, ku u diskutua për pozitën e femrës në MFSK/FSK, sfidat dhe të drejtat e tyre.

Gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2015, janë organizuar seminare nëpër të gjitha njësitë e FSK-së me temën “Diskriminimi gjinor dhe ngacmimi seksual” Seminarin e ka organizuar Zyrtarja për barazi gjinore në bashkëpunim me anëtarët e rrjetit për Barazi Gjinore në KFT.

Përqindja e femrave në uniformë në pozita vendimmarrëse është 6.27 %.



▪ Aktivitet i realizuar nga KJDNJ në MSFK

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim gjatë këtij viti, ka organizuar aktivitetet me moton: “Ta njohim shëndetin tonë”, me ç’rast 28 punonjëse bënë EHO dhe Mamografinë e gjirit. Ky aktivitet u organizua për solidarizim, dhe përkrahje e grave të prekura nga kanceri i gjirit. Po ashtu janë përgatitur edhe dy broshura: “Stop Dhunës në Familje”, dhe “E Drejta e Gruas në Pronë”, në kudër të fushatës për ngritjen e vetëdijes dhe mirëqenies së shoqërisë sonë.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Infrastrukturës edhe këtë vit ka vazhduar me projektin “Ta parandalojmë se sa ta luftojmë”, në kuadër të Muajt Ndërkombëtarë të Luftës Kundër Kancerit të Gjirit, ku janë bërë vizita mjekësore të mamografisë, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (Onkologjisë) në Prishtinë.

Projekti është paraparë për gratë dhe vajzat punonjëse të MI-së gjithsej 66 femra, me qëllim të promovimit të politikave dhe programeve shëndetësore.

Po ashtu, janë organizuar edhe aktivitete me rastin e shënimit të 25 nëntorit, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, ku është publikuar broshura “Ligji për Barazi Gjinore”.

Statistikat e punësimit në Ministrin e Infrastrukturës për vitin 2015 duken si vijon:

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në MI është 262, nga të cilët 195 ose 74,42% janë meshkuj, kurse 67 ose 25,58% janë femra.



▪ Aktivitet i realizuar nga ZBGJ në MKK



▪ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MI

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal me rastin e hapjes së fushatës “16 Ditëve të Aktivizimit, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas”, ka organizuar tryezë të rumbullakët me zyrtarët e MAPL-së, ku gjatë tryezës u tha se të gjithë duhet të angazhohen për parandalimin e dhunës në familje dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëz në Republikën e Kosovës, për të gjithë pjesëmarrësit u shpërnda kordelja e bardhë. Po ashtu gjatë këtij vitit janë realizuar edhe dy fletëpalosje mbi të drejtën pronësore të gruas “ Si fitohet trashëgimia”, Kush janë trashëgimtarët ligjor”.



▪ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MAPL

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë ka realizuar aktivitete konfom detyrave dhe përgjegjësi-ve qe ka. Në mbështetje të OSBE-së ka mbajt trajnime për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në familje në Kosovë, për profesionistet shëndetësor, se si do te trajtohen rastet e dhunës, regjistrimi i tyre i veçantë dhe si te jenë konfidenciale. Trajnimet janë mbajt në regjionin e Prizrenit, Pejës, Klinë, Istog, Deçan, Gjilan, ku te ftuar kanë qenë stafi mjekësor nga Emergjencia në kuadër te Spitaleve, QKMF-te dhe Qendrat e Shëndetit Mendor në shërbimet shëndetësore dhe janë trajnuar 180 profesionist Shëndetësor.

ZBGJ ka mbajt tryezën në regjionin e Prizrenit dhe Prishtinës, ku kanë marr pjesë gjithsejtë 54 profesionist shëndetësor për dhunën në familje më stafin e QKM Qendrat e shëndetit mendor në regjionin e Prizrenit dhe Prishtinës, për identifikim dhe referimin e rasteve të sistemit shëndetësorë, është analizuar dhe diskutuar nga ana e profesionisteve shëndetësor, identifikimi i rasteve të dhunës ne familje dhe të mbijetuarat e dhunës se bazuar në gjini, të cilët do të punojnë në bazë te Udhërrëfyesit mbi Dhunën e Bazuar në Gjini.

Për vitin 2016 në Ministrin e Shëndetësisë ka hyj edhe buxheti gjinore i planifikuar për fushën e Barazisë gjinore & dhunë në familje ne implementimin e aktiviteteve dhe Planeve të veprimit .

Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit ZBGJ ka mbajtur tryezë diskutimi me fokus për dhunën në familje, ngacmimin seksual, të drejtat e të mbijetuarave të dhunës seksuale, pjesëmarrës në këtë tryezë kanë qenë i gjithë stafit shëndetësorë.

MSH ka lidhur marrëveshje me Koalicionin e Strehimoreve dhe Qendrën për Rehabilitim e të Mbijetuarve të dhunës seksuale të luftës, ku janë shpërndarë barëra te listës vitale. Ne te gjitha strehimoret e Kosovës dhe janë bërë vizitat sistematike nga ana e profesionistëve shëndetësor sa herë që ka qenë e nevojshme.

Sa i përket shërbimeve që kanë kërkuar rastet e dhunës në familje në Institucionet shëndetësore regjionale është si vijon:

- Qendra kryesore e mjekësisë familjare në Podujevë ka regjistruar 78 raste të dhunës në familje, që kanë marr shërbime në Emergjencën e QKMF.
- Qendra kryesore e mjekësisë familjare në Mitrovicë ka regjistruar 19 raste.
- Qendra kryesore e mjekësisë familjare në Fushë Kosovë ka regjistruar 15 raste.
- Qendra kryesore e mjekësisë familjare në Viti ka regjistruar 43 raste.
- Si dhe Spitali i Mitrovicës ka trajtuar një rast të dhunës në familje.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me OSCE-në ka vazhduar raundin e dytë të trajnimit për Trajnues “Përkatesia gjinore dhe të drejtat në pronë në Kosovë”. Trajnimi është mbajt më 31 mars–1 prill 2015.

Ky trajnim kishte si qëllim kryesor rritjen e njohurive të zyrtarëve të MMPH-së për barazinë gjinore dhe përmirësimin e qasjes së grave në të drejtat në pronë dhe banim në Kosovë. Në trajnim kanë marr pjesë pjesë përafërsisht 40 pjesëmarrës.

Po ashtu, në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas është organizuar një tryezë diskutimi për punëtorët e Ministrisë me temën “Barazia Gjinore dhe Diskriminimi i Grave në Kosovë”.

Sa i përket të punësuarve në MMPH është si vijon: Totali: 218 të punësuar, ku prej tyre 126 meshkuj dhe 92 femra.



▪ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MMP

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Qendrën e Studentëve ka raportuar mbi të dhënat e ndara në gjini sa i përket punësimit dhe numrit të studentëve në këtë qendër.

Statistikat e shkallës së realizimit të Barazisë Gjinore në Qendrën e Studentëve për vitin 2015

Nr. total i të punësuarve	Meshkuj	Femra	Përqindja e femrave
232	164	68	25%

Femra në pozita udhëheqëse në Qendrën e Studentëve

Nr. total i punëtoreve në vende udhëheqëse	Meshkuj në udhëheqje	Femra në udhëheqje
7	5	2-përqindja 28.5%

Nr. i studenteve në Qendrën e Studenteve

Nr. total i studentëve	Meshkuj	Femra	Përqindja
3448	1037	2141	62%

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Kulturës Rinis dhe Sporteve ka raportuar për aktivitete e ndërmarr nga kjo ministri ku edhe këtë vit MKRS është angazhuar për promovimin e gruas me qëllim të reflektimit të vlerave artistike në veprimtari të ndryshme kulturore, sportive dhe shkencore. Nga departamenti i Kulturës të MKRS, konkretisht nga Sektori i Promovimit janë mbështetur 18 projekte po aq edhe nga Sektori i Industrisë Kreative, ndërsa nga Sektori i Diplomacisë Kulturore janë mbështetur 5 projekte ndërkaq nga sektori i Diversitetit dhe dialogut kulturor –komunitete jo-shumicë 23 projekte. Edhe Divizioni i librit dhe bibliotekave ka mbështetur 10 projekte me bartëse femrat, ndërsa 4 projekte tjera janë mbështetur nga sektori i Arteve vizuale..

Promovimit të femrave i ka kushtuar kujdes edhe Departamenti i Rinisë, ku ka mbështetur një numër të madh projektesh me bartëse femra, për realizimin e të cilave janë ndarë mbi 91 mijë euro. Për 34 mijë projekte dhënë organizatave të ndryshme joqeveritare me bartëse femra Divizioni për Integrim dhe Parandalim Shoqëror për vitin 2015 ka ndarë një shumë prej 42.325 euro. Divizioni për Zhvillim të Politikave Rinore, ka përkrahur 18 projekte dhe është ndarë shuma 35.612 euro, kurse Divizioni për Promovim, Edukim Jo-Formal, Punësim dhe Ndërmarrësi gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015, në sektorin e Punësimit ka mbështet 5 femra për hapjen e start up bizneseve me shumën e përgjithshme 12,355.00.

Një kontribut të veçantë në mbështetje të projekteve të femrave për zhvillimin e aktiviteteve sportive femërore në kuadër të Federatave Sportive për mbarëvajtjen e ligave të Kosovë e ka trenguar Departamenti i Sportit.

Divizioni i Federatave edhe gjatë vitit 2015 ka trajtuar këtë politikë si një prej parimeve esenciale të sportit duke ndarë një buxhet të konsideruar për këtë synim por njëherit duke mundësuar që klubet e femrave të jenë edhe përfituese të politikave tjera programore.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka raportuar për përkrahjen që kjo ministri bënë për gratë përmes ndarjes së subvencioneve.

Ministria e Bujqësisë, gjatë viteve të fundit, përmes granteve investive dhe subvencioneve, ka arritur që të përkrah një numër të madh të femrave, të cilat përmes kësaj përkrahje po arrijnë që të zgjerojnë veprimtaritë e tyre bujqësore. MBPZHR gjatë viti 2014 ka ndarë subvencione në vlerë totale 8,945,690.71, prej tyre 188 ose 83.19% janë meshkuj dhe 38 ose 16.81 % femra, që i bie 24.77% e buxhetit është ndarë për femra.

Zyrtarja për Barazi Gjinore, Mundësi të Barabarta në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ka raportuar mbi të dhënat në lidhje me rastet e dhunës në familje, të cilat kanë kërkuar ndihmë në këtë qendër.

Gjatë mbledhjes së dhënave ka hasur në numër të konsiderueshëm të femrave që kanë kërkuar ndihmë dhe shumica e tyre janë evidentuar si maskime të rastit, dhe besohet që pasojat kanë qenë rezultat i dhunës në familje. Nga këto raste të evidentuara ka pasur raste kur pacienti nuk ka mundur t'i shpëtojë vdekjes.

Duke u bazuar në të dhënat e mbledhura në QKUK, dhuna në familje vazhdon të jetë tejet prezentë edhe në Kosovë.

Raporti për numrin e shënuar dhe të evidentuar, marr nga QKUK nga muaj Janar-Dhjetor 2015.

Aktivitetet e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Nr.	MUAJT	Intoksikime	Rrahje	Armë të zjarrta	Armë të ftohta	Të vdekur
1	JANAR	23	21	11	3	1 A.Z
2	SHKURT	20	19	4	10	
3	MARS	17	19	2	11	
4	PRILL	26	26	3	17	
5	MAJ	16	33	1	9	1.i.
6	QERSHOR	28	17	6	12	2.A.1.i
7	KORRIK	41	38	6	7	2.A.1.i
8	GUSHT	29	45	7	10	1.A.1.I
9	SHTATOR	33	39	6	13	1
10	TETOR	24	23	20	32	
11	NËNTOR	20	26	8	11	
12	DHJETOR	20	45	7	15	
Rezume prej Janarit deri Dhjetor		282	345	64	124	
Rastet të cilat kanë përfunduar me vdekje		7		2		



▪ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Mitrovicë

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Mitrovicës përgjatë vitit 2015 ka realizuar një serë aktivitetesh. Duke filluar me shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas 8 Marsin, në bashkëpunim me Komitetin për barazi gjinore të Kuvendit të Komunës dhe Grupin e Grave Asambleiste, kanë organizuar në Qendër të Kulturës “Rexhep Mitrovica” shfaqjen e filmit “Engjujt e Hekurt” i cili ka treguar sfidat nëpër të cilat kanë kaluar gratë për të fituar të drejtën e votës. Në kuadër të shënimit të kësaj date janë ndarë 30 mirënjohje për Gratë mësuese veterane të arsimit të ulët fil-lor, të cilat tashmë janë pensionere. Po ashtu, është vizituar OJQ, Zëri i Prindërve, ku janë takuar me 30 gra kryefamil-jare.

Në muajin tetor, muaj për ndërgjegjësimin për kan-cerin e gjirit së bashku me grupin e grave assembleiste, dhe Komitetin për barazi gjinore, Komitetin për Shëndetësi dhe Ojq-në, Mundësia, është organizuar tryezën për vetëdi-

jesim dhe sensibilizim për kancerin e gjirit, në kuadër të këtij aktiviteti janë shpërndarë fllajera me një slogan dhe udhëzime se si ta parandalojmë sëmundjen e kancerit të gjirit.

Ndërsa, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eli-minimin e Dhunës ndaj Gruas, është organizuar konferen-ca me temën “ Ndal dhunën ndaj femrës” .

Po ashtu, nga nën kodi i ndarë për çështje gjinore në komunën e Mitrovicës janë subvencionuar këto organizata lokale të Mitrovicës : OJQ - “Me dorë në zemër”

OJQ - “ Mitrovica Women Association for Human Rights” OJQ - “ Opfakos ”OJQ - “Down Syndrome Kosova “ OJQ - “CECD - Friends “OJQ - “Handikos “ OJQ - “ KBK Trepça “OJQ - Qendra për mbrojtjen e Gruas “ Raba Voca” dhe OJQ - “ Amza “.

Aktivitetet e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Drenasit në bashkëpunim me shoqatën për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas, për fushatën 16 ditët e Aktivizimit (25 nëntor deri me 10 dhjetor), ka organizuar disa aktivitete. Duke filluar me shpërndarjen e kordeles së bardhë për të gjithë punonjësit, si dhe ka shpërndarë fletushkat dhe postera, në të gjitha institucionet dhe nëpër qytet. Janë vizituar viktimat që kanë përjetuar dhunë në familje, si dhe janë mbajtur debate me gra.

Në përmbyllje të fushatës është organizuar tryezë me përfaqësuesit e të gjitha institucioneve që merren me trajtimin e viktimave të dhunës në familje.

Rstet e dhunës në familje në këtë komunë për gjashtëmuorin e parë të vitit 2015 (nga QPS), janë të paraqitura 11 raste, prej tyre të gjitha femra.

Gjithsejtë të punësuar staf civil në komunën e Drenasit janë :

Sektori	Femra	Meshkuj	Nr. i tërësishëm
Administrata	40	97	137
Arsimi	255	709	964
Shëndetësia	97	102	199
Gjithsejtë	392	908	1300



▪ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Dragash

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Dragashit ka mbajtur aktivitete të ndryshme bazuar në Planin Nacional të Veprimit për arritjen e Barazisë Gjinore por edhe në Planit lokal të Veprimit për Barazi Gjinore. Fillimisht shënimi i 8 Marsit, është realizuar bashkarish me gratë e institucioneve, me një vizitë grave punëtore, në fabrikën e koleksionit 'Invers One' - , në fshatin Shajen. Për ta shënuar këtë ditë është mbajtur edhe një mbledhje e Asamblesë komunale me tema çështja gjinore dhe në fund është shfaqur dokumentari "Unë ja dola! Mundesh edhe ti", mbështetur nga OSCE.

Ndërsa, gjatë fushatës së 25 Nëntorit Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas është mbajtur marsh me nxënës, ligjërata në shkollë, informimi përmes radio-spotëve elektronike, informimi përmes postimit të

informatave dhe fotove përmes faqes së facebook të MK, po ashtu është mbajtur një tryezë diskutimi, ku te pranishëm ishin Zv. Ministri Lirak Çelaj, Flora Macula, shefe e UN-WOME , Kryetari i Komunës Salim Jonuzi , anëtarët e Mekanizimit Kundër Dhunës ne Familje, drejtor shkollash dhe bashkëpunëtor tjerë. Në mbështetje të komunës dhe në bashkëpunim me G.G dhe QPS janë nda nja 100E për pesë nëna kryefamiljare apo vetushqyese.

Ndërkaq me qëllim të ngritjes së vetëdijes rreth barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, gjatë këtij viti janë realizuar disa ligjërata me grupe të ndryshme të kursisteve në Dragash, me tema si : Barazia Gjinore dhe roli i saj në shoqëri, Trashëgimia dhe çështja e pronës së gruas, Dhuna në Familje dhe pasojat e saj etj.

Aktivitetet e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna



▪ Aktivitetet i realizuar nga ZBGJ në Fushë Kosovë



▪ Aktivitetet i realizuar nga ZBGJ në Pejë

Ndërkaq, për fushatën e 16 Ditëve të Aktivizimit është organizuar tryeze e rumbullakët me temë “Dhuna ndaj Gruas”. Tryeza kishte si qëllim sensibilizimin gjithëpërfshirës të opinionit në zbatimin e mekanizmave dhe parandalimin e dhunës në baza gjinore.

Në komunën e Pejës të punësuar në shërbimin civil janë gjithsejtë 303, meshkuj 200 ndërsa femra 103. Në Asamblenë e komunës janë 35 persona 25 meshkuj dhe 10 femra.

Po ashtu në këtë komunë është qendrat për punë sociale- strehimoret, ku qe nga viti 2002 deri me tani janë strehuar 980 persona nga ta 622 gra, ndërsa 358 fëmijë. Por ajo çka vlen të theksohet është se shumica e grave janë aftësuar për përgatitjen e gjellëve, ëmbëlsirave, për punën e floktarisë, për rrobaqepësi, si dhe puna bazike me kompjuter.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Lipjanit në bazë të plan-programit për vitin 2015 ka zhvilluar këto aktivitete, Ditën Ndërkombëtare të Gruas ka ndarë mirënjohje për gratë që kanë dhënë kontribut të veçantë në lëmi të ndryshme profesionale në komunën e Lipjanit. Janë mbajtur po ashtu takime me grupin e grave të fshatit Magure, ku është diskutuar për formën e aplikimit për përfitime dhe grante me qëllim të zhvillimit të bizneseve të vogla në bujqësi. Me rastin e tetorit muaji i mundësive të barabarta janë realizuar disa aktivitete të ndryshme si punësim dy ditore me dy shoqata të PAK, ku janë punësuar 20 veta, shuma 400€.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë Kosovës, në kuadër të shënimit të 8 Marsit Ditës Ndërkombëtare të Gruas ka organizuar tryezë diskutimi me temë: “Pozita e femrës në nivelin lokal” si dhe panair tre ditore për “Promovimin e artizanaleve dhe produkteve ushqimore” gratë nga viset rurale.

Me qëllim të fuqizimit dhe promovimit të pozitës së gruas, për herë të parë në Fushë Kosovë, është organizuar Java e Gruas, me moton “Gratë lidere të ndryshimeve” me iniciativën e Zyrtares për Barazi Gjinor dhe Grupit të grave Asambleiste, mbështetur nga Komuna dhe OSBE. Kjo javë u hap me një tryezë të përbashkët të grupeve të grave të rajonit të Prishtinës, ku prezentë ishte edhe Kryetari i Komunës z. Burim Berisha, Grupi i grave Deputete të Kuvendit të Kosovës znj. Blerta Deliu me bashkëpunëtore, u diskutua për pozitën e gruas në shoqëri, sfidat dhe të arriturat, po ashtu u prezantuan edhe planet e punës për të ardhmen.

ZBGJ ka mbajtur disa takime me grupe të grave të komunitetit serb, malazezë dhe rom, për t’u njohur më afër me problemet e tyre.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Pejës, në bashkëpunim me Grupin e Grave Asambleiste, si dhe me përkrahjen e komunës ka organizuar Konferencën Rajonale me temë “Pozita e gruas në Vend dhe Rajon”. Në këtë konferencë ishin prezent pjesëmarrëse nga Shqipëria, Maqedonia, dhe Mali I zi, ku u diskutua për sfidat dhe barrierat e pozitës së gruas në vend dhe rajon. Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas me 8 Mars, me iniciativën e ZBGJ janë ndarë çmimet Laureat për gratë më të suksesshme nga këto fusha; arsim, shëndetësi, ekonomi, mirëqenie social si dhe media e kulturë.

Gjithashtu gjatë muajt tetor, muaj kundër kancerit të gjirit i është mundësuar kontrolli me mamografi gjithsejtë 60 grave, nga viset rurale dhe urbane të komunës së Lipjanit.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Dhunës ndaj Gruas, 25 Nëntori, po të njëjtën ditë është mbajtur edhe Kuvendi, ku gjatë takimit është shpërndarë kordelja e bardhë për të gjithë të pranishmit dhe është stolitur edhe Sallën e Kuvendit me lule të bardha dekorativ.

Ndërsa, sa i përket ndarjes së subvencioneve për vitin 2015, Drejtorati i Bujqësisë në komunën e Lipjanit ka nda shumën 3550 E, ku kanë përfitu 22 gra.

Zyrtari për Barazi Gjinore në Komunën e Hanit të Elezit për Fushatën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas ka organizuar tryezë diskutimi me temë “Stop dhunës në baza Gjinore”. Në këtë tryezë ishin të ftuar përfaqësues nga Asambleja Komunale, përfaqësues të OSBE-së, si dhe përfaqësues të cilët ndikojnë në parandalimin dhe eliminimin e kësaj dukurie. Në përmblyllje të fushatës u organizua edhe një ligjërata e mbajtur me nxënës të Shkollës së Mesme të Lartë “Dardania” në Han të Elezit me temën “Stop Dhunës në Baza Gjinore dhe Njohja me të Drejtat e Njeriut”.



▪ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Prishtinë

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Skenderajt gjatë 2015 ka zhvilluar një varg aktivitetesh gjatë 2015, ku gjatë kësaj periudhe ka monitoruar shkollat fillore rreth rasteve të braktisjes së shkollës nga nxënësit, duke diskutuar me drejtoret e shkollave fillore dhe më familjaret e nxënësve që e kanë braktisur shkollën. Ku në mbështetje të Kuvendit Komunal të Skenderajt u është mundësuar vazhdimi i shkolimit dy vajzave njëra në kl. VIII-të dhe tjetra në kl. VI-të, në shkollën fillore në Turqefc.

Po ashtu në bashkëpunim me OJQ SHERA, ka organizuar tryezë të rrumbullakët me temë "Roli dhe Funkcioni i Grave Sipërmarrëse në Agrikulturë".

Në këtë tryezë gratë sipërmarrëse kanë paraqitur nevojat, problemet, interesat dhe kërkesat e tyre me qëllim që të jenë pjesë e integruar në proceset e jetës ekonomike, politike dhe sociale, prezentë kanë qenë edhe Drejtori i Bujqësisë dhe i Financave.

Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit ka përgatitur 150 fletëpalosje me qëllim të ndërgjegjësimit të publikut në luftimin e dhunës në familje. Dhe në dhjetor ka mbajtur një tryezë diskutimi ku është prezantuar Ligji i ri për Barazi Gjinore, të pranishëm kanë qenë nga Gjykata, Policia, OJQ, QPS.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Malishevës ka ndërmarr aktivitete të ndryshme të shënuara përgjatë vitit, në sferën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore. Duke filluar me monitorimin dhe përfshirjen e perspektives gjinore në gjitha aspektet shoqërore, mbledhjen e statistikave në këndvështrimin e barazisë gjinore për punëtorët e shërbimit civil të komunës së Malishevës dhe të papunësuarve të regjistruar në entin e punësimit, po ashtu për rastet e dhunës në familje dhe adresimi tek organet kompetente për mbrojtjen e viktimave, aktivitete sa i përket trashëgimisë pronësore, realizimi i pyetësorit për dhunën në familje, gjithësejtë 511 pyetësor etj.

Në shënimin e 8 Marsit komuna ka shpërblyer femrat me të suksesshme për kontributin që kanë dhënë për fuqizimin e gruas në Malishevë. Rreth sensibilizimit dhe vetëdijësimit të femrave janë mbajtur gjithësejtë dy takime për të drejtën trashëgimore respektivisht të drejtën e pronës, në bashkëpunim me Partners Kosova. Janë mbajtur takime të rregullta me Grupin e Grave Asambleiste, me OJQ, Qendra për punë sociale etj. Së bashku me GGA janë mbajtur takime me drejtorin e shëndetësisë dhe doktoreshën e specializuar në këtë lëmi, rreth kancerit të gjirit me ç' rast janë kryer rreth 200 vizita pa participim, po ashtu kanë vazhduar edhe vizitat sistematike nëpër shkolla ku janë përfshirë të gjitha shkollat e komunës. Po ashtu është realizuar fletëpalosja ku përfshihen të gjitha aktivitetet dhe statistikave e pyetësorit të realizuar për dhunën në familje.

Të dhënat sa i përket të punësuarve në komunën e Malishevës janë siç vijon: Numri i përgjithshëm në Komunë është 157, ku 131 janë meshkuj, ndërsa 26 femra, të punësuar në Arsim janë 1132 gjithësejtë, 819 meshkuj, ndërsa 314 femra dhe në Shëndetësi janë 122, ku prej tyre 63 meshkuj dhe 59 femra.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Prishtinës ka realizuar fushata sensibilizuese në shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas ku në bashkëpunim me organizatën Un-women ka organizuar ekspozitë me fotografi "Heronjtë dhe Heroinat e përditshme të barazisë gjinore", po ashtu nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe mirëqenies sociale janë ndihmuar dy viktima të dhunës në familje me pagesë e vendbanimit përgjatë njëviti.

Në kuadër 16 Ditëve të Aktivizmit, fushatës sensibilizuese kundër dhunës ndaj gruas janë vendos edhe disa posterë me moton "Burrat e vërtetë kurrë nuk ushtrojnë dhunë ndaj gruas!" në bashkëpunim me OSBE.

Ndërsa, në bashkëpunim me KFOR-in Italian dhe në mbështetje të Drejtorisë së Arsimit është mbajtur projekti me temë "Ngacmimet seksuale", në shkollën Xhevdet Doda kl- XI.

Po ashtu janë përgatitur dhe shpërndara broshura me moton "Paqja në Botë, fillon me Paqen në Shtëpi".



▪ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Skenderaj

Aktivitetet e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Vushtrrisë për nder të Ditës Ndërkombëtare të Gruas 8 Marsi, në bashkëpunim me Grupin e Grave Asambleiste ka organizuar një tryezë të rrumbullakët, ku u diskutua për të drejtë e gruas në pronë, pjesëmarrëse në këtë tryezë kanë qenë 20 gra.

Në kuadër të bashkëpunimit reciprok të Zyrës për Barazi Gjinore të Komunës së Dragashit dhe të Vushtrrisë, në komunën e Vushtrrisë qëndroi një delegacion i përbërë nga përfaqësuese të kësaj zyre, ansambleiste dhe përfaqësuese të shoqërisë civile si dhe volejbollistet e klubit të posa formuar të Dragashit.

Me këtë rast delegacioni i grave nga Komuna e Dragashit u pritën nga kryetari Bajram Mulaku, i cili shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin reciprok si dhe i informoi lidhur me historikun, zhvillimin ekonomik dhe rrjedhat aktuale në Komunën e Vushtrrisë.

Gjatë ditës u zhvillua edhe ndeshja e kthimit në volejball në mes të volejbollistëve vushtrrias që bëjnë gara në Super Ligën e Kosovës dhe skuadrës së po sa formuar nga Dragashi, mysafiret nga Dragashi vizituan edhe monumentet e trashëgimisë kulturore si dhe bënë një shëtitje në Bulevardin “ Adem Jashari”.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Vitisë përgjatë vitit 2015 ka organizuar takime të ndryshme për promovimin e barazisë gjinore gjegjësisht buxhetimin gjinor, fushë e re kjo që ndikon në luftimin e pabarazive gjinore dhe aplikon një barazi në shpërndarjen e drejtë dhe të përgjegjshme të buxhetit komunal. Janë mbajtur debate, tryeza të ndryshme për çështjen e barazisë gjinore, trajnime për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut për avokim dhe lobim si dhe punëtori për buxhetim sensiti, ku për aplikimin e buxhetimit gjinor, Komuna e Vitisë ka ndër marrë masa duke filluar të bëjë analizë gjinore të shpenzimeve publike, që gjerë më tani është bërë analiza në paga dhe mëditje, ndërsa në kategoritë tjera ekonomike është duke u punuar që të bëhet një analizë gjinore.

Sa i përket punësimit të femrës, në komunën e Vitisë në sektorin publik janë të punësuar gjithsejtë 426 femra. Në sektorin e Arsimit, është arritur progres për vitin 2015 sa i përket përfaqësimit të femrës, pasi që në vitin 2014 përfaqësimi i femrës në personelin arsimor ishte 36%, ndërsa në vitin 2015 kjo përqindje është rritur në 40%.

Në sektorin e shëndetësisë, është një përfaqësim i mirë i femrave, ku kemi 62 % të femrave të punësuar.

Ndërsa, në Administratën Komunale, ekziston një disbalancë e fuqishme gjinore. Nga 146 punëtorë që numërohen gjithsejtë, 19 prej tyre janë femra, apo shprehur në % vetëm 13 %.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Obiliqit në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas ka mbajtur një tryezë të rrumbullakët me temë „Rëndësia e Gruas dhe femrës në shoqërin tonë“. Në këtë tryezë kanë marr pjesë të gjitha OJQ –të, gratë në pozita vendimarrëse si dhe egzekutivi. Në fund të takimit u ndan mirnjohje për disa gra të cilat kanë dhënë kontribut në arsim dhe shëndetsi në komunën e Obiliqit. Gjatë këtij viti është realizu projekti „Panairi i Grave me Ushqime Tradicionale“, ky panair është realizu me rastin e ditës së komunës ku janë përfshi gratë e të gjitha komuniteteve gjithsej kanë marrë pjes 11 gra.

Qëllimi i këtij projekti ka qenë fuqizimi ekonomik i grave, rritja e mundësive të marketingut për gratë sipërmarrëse të komunës, projekti në fjalë është realizu në bashkëpunim me Grupin e grave dhe OJQ- „Aureola“. Me rastin e 16 Ditëve të Aktivizimit janë realizu këto aktivitete:

vënja e kurdeles së bardhë për të gjith puntorët dhe egzekutivin, mbajtja e një ligjerate në dy shkollat e mesme „Hasan Tahsini „ dhe „17 Shkurti“ ligjerata ka qenë me temën kundër dhunës në shkolla dhe familje.

Sektori	Femra	Meshkuj	Nr. i tërësishëm
Administrata	19	127	146
Arsimi	323	471	794
Shëndetësia	84	50	134
Gjithsejtë:	426	648	1074

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Rahovecit ka zhvilluar aktivitete të shumta përgjatë vitit, janë mbajtur takime të rregullta me Grupin Jo Formal të Grave, në këto takime janë shqyrtuar tema të ndryshme sa i përket gjendjes në komunën e Rahovecit, rreth çështjeve gjinore: si dhuna në familje shkaqet dhe pasojat e saj.




Në kuadër të 8 Marsit-Ditës Ndërkombëtare të Gruas është mbajtur një takim ku Kryetari i kësaj komune ka ndarë mjete financiare për 30 familje me nevojë. Janë realizuar edhe një serë vizitash tek gratë biznesmenë në komunë. ZBGJ ka prezantuar Ligjin për Barazi Gjinore ku kanë qenë pjesëmarrës udhëheqës të komunës, nënkryetari i komunës dhe udhëheqësit e institucioneve të ndryshme.

▪ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Rahovec

3 muaj në qendër për aftësi profesionale në Prizren, si dhe janë certifikua për zanatet e përzgjedhura nga vet ata dhe janë pajis me mjete pune, për secilin në vlerë 1400€ për tu integruar në shoqëri dhe të fillojnë një biznes të vetin). Në fund të këtij projekti është përgatit një broshurë me përmbledhje të aktiviteteve të realizuara gjatë projektit me temë: “Promovimi i të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e pakicave në Evropën Juglindore”.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Kamenicës gjatë fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit në bashkëpunim me Zyrtaren e NJKDNJ si dhe me anëtarët e Grupit të Grave të Kamenicës vizituan Stacionin Policor të Kamenicës, përkatësisht Njësinë Dhuna në Familje, me ç’ rast u takuan me përgjegjësen e këtij sektori znj. Mirsije Katrati. Qëllimi i takimit ishte informimi rreth numrit të rasteve të dhunës në familje gjatë këtij viti. Në këtë komunë rastet e dhunës ndaj grave janë në rënie e sipër, ku gjatë këtij viti janë gjithsej 9 raste, prej tyre 5 janë shqiptare, 3 serbe dhe një rome, pra në krahasim me vitet paraprake kemi të bëjmë me zvogëlim të dhunës ndaj grave. Gjatë kësaj dite janë shpërnda fletëpalosje me informacione sa i përket rëndësisë së kësaj dite, të përgatitura nga Koordinatorja e NJKDNJ-së me qëllim të sensibilizimit të qytetarëve kundër dhunës ndaj gruas. Po ashtu gjatë kësaj fushate janë vizituar edhe shkollat fillore ku është ligjëruar për dhunën në familje. Komuna e Kamenicës për vitin 2015 ka ndarë një banesë për një grua e cila ka qenë viktimë e dhunës në familje.



▪ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Prizren

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Prizrenit ka realizuar aktivitete të ndryshme bazuar në Planin Nacional të Veprimit në fushën e të drejtave të njeriut, mbajtja e takimeve të rregullta me organizata joqeveritare rreth realizimit të projekteve dhe mbështetja e tyre.

Janë mbështetur OJQ Kluç -500 E për projektin e Vetëdijesimit të femrave të komunitetit boshnjak për drejtat e tyre dhe martesat e hershme. OJQ Femra për femrat është mbështet me 1600E për kursin e rrobaqepësisë dhe me 1000 E për hartimin e Planit të veprimit për PAK,

OJQ Shtjefan Gjeqovi është mbështetur me 3000 E për botimin e dy numrave të gazetës “Gruaja në fokus”. Strehimorja e grave është mbështetur me 15 m dru dhe i është rregulluar oborri i ndërtesës. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Gruas 8Marsi është mbajtur në bashkëpunim me Asambleistët komunale me temë “Ngritja e rëndësisë së rolit të gruas”

Me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit të opinionit të gjerë për shtimin e përkujdesjes për shëndetin e femrave gjatë muajit Tetori dhe Nëntori janë kryer rreth 400 kontrollime falas me ultrazë dhe mamografi në QKMF, rreth 200 nxënës kanë dëgjuar ligjërata për simptomat dhe parandalimin e kancerit në gji, si dhe është sensibilizuar opinioni përmes fletëpalosjeve dhe posterave me informata dhe mesazhe parandaluese për këtë dukuri.

Po ashtu përmes botimit të dy gazetave “Gruaja në Fokus” për muajin qershor dhe dhjetor janë promovuar aktivitete të grave dhe rolit të tyre në vendimmarrje.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Gjakovës ka kryer aktivitete të shumta që prekin fushën e barazisë gjinore. Me iniciativën e saj dhe nën patronatin e Kryetares së Komunës, Mimoza Kusari Lila dhe me mbështetje të zyrës së UNWOMEN në Kosovë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas është organizuar Konferenca Rajonale me temë: “Sfidat dhe të arriturat e gruas shqiptare në periudhën e pas luftës”. Punimet për Konferencën Rajonale të Gruas, janë organizuar në katër panele, me tema të llojlojshme që i përkasin sfidave dhe të arriturve të gruas shqiptare në periudhën 15 vjeçare pas luftës së fundit në Kosovë. Në panelin e parë janë prezantuar temat që trajtojnë pasojat që ka përjetuar gruaja gjatë dhe pas luftës, po ashtu tema për gruan, paqen dhe sigurinë. Në panelin e dytë është diskutuar tema “Fuqizimi ekonomik i gruas për të përmirësuar mirëqenien ekonomike-sociale.

Gruaja në vendimmarrje dhe sfidat në këtë rrugëtim, ishte tema e tretë e panelit, kurse në panelin e katërt është diskutuar për shëndetin e gruas dhe jetën vitale që garanton një familje dhe shoqëri të shëndoshë.

Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Gruas është organizuar tryezë diskutimi si dhe nënshkrimi i marrëveshjes për dhënien në prioritet viktimave të dhunës në familje, gjatë ndarjes ose dhënies në shfrytëzim të banesave sociale. Po ashtu janë përgatitur disa materiale sensibilizuese.

STATISTIKAT E TË PUNËSUARVE NË SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi që ka për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil dhe hartimit të politikave për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, në çdo tremujor, DASHC-i harton raporte për politikën e punësimit mbi baza të përfaqësimit etnik, gjinor dhe të përgatitjes shkollore të shërbyesve civilë. Sipas të dhënave dhe shënimeve të mbledhura në terren, numri i të punësuarve në institucionet e administratës qendrore (ministri dhe agjenci) niveli i lart drejtues është 72, prej tyre 64 ose 94.4% meshkuj, ndërsa 4 ose 5.56% femra. Në nivelin drejtues 959 ose 73.71 janë meshkuj, ndërsa 342 ose 26.29% femra.

Ndërkaq, numri i të punësuarve në institucionet e administratës komunale është 874, prej tyre 702 ose 80.3% janë meshkuj, ndërsa 172 ose 19.7% janë femra (pa përfshirjen e pozitave udhëheqëse në arsimin, si dhe pa përfshirjen e pozitave udhëheqëse në shëndetësi në nivelin lokal)

Sqarim: Në këto të dhëna nuk përfshihen postet politike.



■ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Gjakovë

Një pjesë e materialeve janë shpërnda nëpërmjet qendrave shëndetësore të mjekësisë familjare, dhe të institucioneve arsimore. Pra gjithsejtë janë publikuar rreth 300 fletëpalosje dhe 100 postera sensibilizues për fenomenin e dhunës në familje dhe për ekzistencën e Mekanizmit Koordinues e shërbimeve që ai ofron në luftimin e dhunës në familje.

ZBGJ në bashkëpunim me “Rrjetin Qeliza” ka organizuar trajnimin me temën “Fuqizimi i grave në vendimmarrje”. Pjesëmarrëse në trajnim ishin këshilltaret komunale dhe gratë në pozita vendimmarrëse të komunës, zyrtare komunale, përfaqësuese nga shoqëria civile, përfaqësuese gra nga bizneset, mediat.



info@abgj-ks.net